



AKT THEMELI DHE STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"SOLID 23" SHPK

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"SOLID 23 " SHPK**

Sot më datë 22.05.2023 u paraqit personalisht:

• **Dorian Kodra**, atësia Bashkim, amësia Sadije, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Rruga Panjohur; Durrës; 0000; Durrës, lindur më 27/02/1989, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037603456 dhe nr. personal I90227080H

Ne baze te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqëritë tregtare" dhe ne ligjt Nr. 9723, date 03.05.2007 për Q.K.B, kërkoi redaktimin e Aktit te Themelimit dhe Statutit te Shoqërisë me përgjegjësi te kufizuara si me poshtë vijon:

**NENI I
EMERTIMI I SHOQERISE**

- 1.1 Emri i shoqërisë është "SOLID 23 " Shpk (me poshtë e quajtur "Shoqëria").
NENI 2

SELIA LIGJORE

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresë ne: Rruga ' Minela Karajani' Nr i Pasurise 139/4 Zona Kadastrale 3550, Tirane, Shqipëri.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund te vendose mbi transferimin e selisë se Shoqërisë ne një adresë tjeter. Organi administrues i Shoqërisë mund te themeloje ose mbyllë dege dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës se Shqipërisë.

**NENI 3
KOHEZGJATJA**

- 3.1 Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj për një periudhe te pacaktuar

**NENI 4
OBJEKTI I SHOQERISE**

- 4.1 Shoqëria ka për objekt te saj kryerjen e te gjitha aktiviteteve qe një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar mund te ushtroje ne baze te legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë, duke përfshire por pa u kufizuar ne;

Objekti

Ne fushën e projektimit dhe te ndërtimit; kat. 1/e- planvendosje e objekteve te veçanta, kat. 2/a, projektime dhe ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore etj. Deri ne dy kate qe kompletimin me instalimet e nevojshme për to, b- projektime dhe ndërtime civile industriale, turistike, bujqësore etj. Dhe kompletimin e instalimeve te nevojshme për to; d- Projektim peizazhi (sistemime, lulishte, vepra arti, dekor etj.) e- projektim interieri, mobile.

Ne fushën e ndërtimit për zbatim: punime dhei, sistemime, tarracime, prodhim elementesh te parafabrikuara betoni e betonarmeje dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to, ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore etj. Dhe kompletimi me instalimet e nevojshme për to, punime elektrike, linja TL, TU, impiante elektrike, telefoni, citofoni, dhe mirëmbajtja e tyre, ndërtim rruge, kat. V, VI ndërtime rruge kat. III, II, I, ndërtim fusha aviacioni, veshje asfaltobeton te rrugëve (ndërtim mbishtrese) si dhe sistemim e asfaltim sheshe, ndërtim vepra arti rrugore dhe hekurudhore, ndërtime ujesjellesa dhe kanalizime, sillosa, kulla, kulla uji. Pre betonarmeje dhe metalike, punime karpentjerie metalike, shpime pusesh gjeologjike inxhinjerike dhe hidrogeologjike, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash, niveli me topografike, punime topogeodezike, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, veshje fasadash. Nivelime topografike, punime topogeodezike, punime sipërsaqe te gjelbëria parqe, lulishte, instalimi i impianteve ngritëse dhe transportuese (ashensorë etj.) instalimi i impianteve te ngrohjes dhe fitohjes, instalimi i impianteve higjenike, instalimi i impianteve nenpresion, restaurimi i ndërtesave monument kulture, punime restaurimi i ndërtesave monument kulture, punime restaurimi ne vepra arkeologjike, ndërtime gazsjellëse, naftesjellese, ndërtime diga, galeri, tunele, punime mbrojtje te sistemimit hidraulik- çimentime, kanale dhe impiante vaditje, punime karpentierë druri dhe metali, instalimet dhe impianteve nenpresion, instalimet për nënstationet, kabinet e transformatorëve.

Prodhim, import –export beton, beton armeje dhe çdo nënproduktit te tij, interte etj.

Organizimi i transportit te udhëtareve dhe te mallrave me mjete te komunikacionit ajror, tokësor dhe detar, çelja e zyrave te agjencive turistike dhe te shitjes se biletave për udhëtime brenda dhe jashtë vendit mete gjitha llojet e mjeteve, organizimin e shërbimeve, ndihme juridike, kurse profesionale për gjuhe te huaja, kompjuter dhe sekretari, shitje kancelari.

Ne fushën e tregtisë import – eksporti, me shumice dhe pakice, te mallrave industriale, ushqimore, bujqësor dhe blektorale, veshmbathje, konfeksione, prodhime e tregtim te materialeve te ndërtimit, inerte, rëre, zhavorr, automjeteve, makinerive, pajisjeve hidrosanitare, mobileve, artikujve kozmetike, lendeve te përpunuara dhe te

papërpunuara, e bimëve medicinave, te lendeve drusore, plastike, duraluminit, tregtim me pakice te karburanteve dhe vajrave lubrifikante.

Ne fusha te tjera hapjen e bar bufeve, restoranteve, pikave te servilit, parkim automjetesh, lavazhit, hoteleve, fshatrave turistik, moteleve si dhe agjencive për shitblerje, dhënie me qira te pasurive te tundshme dhe te patundshëm, agjencive për shitblerje, agjenci komisioneve, agjenci transporti, transport te udhëtareve dhe te mallrave si brenda vendit ashtu dhe jashtë tij.

4.2 Për te realizuar objektin e aktivitetit te saj, Shoqëria mund te veproje ne Shqipëri dhe jashtë, dhe te kryeje çdo aktivitet tjetër te nevojshëm, te lidhur, instrumental, te përafërt, elementar, ose sidoqoftë te dobishëm, për shembull:

NENI 5 **KAPITALI I SHOQERISE**

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është i barabarte me 100.000 Leke (njeqindmije Leke), i shlyer plotësisht, me para, nga ortaku **Dorian Kodra**.
- 5.2 Kapitali i Shoqërisë perbehet nga 1 kuota, te ndara si me poshte vijon:
 - *I kuote qe perben 100% te kapitalit, me vlerë te per gjithshme 100.000 Leke, e shlyer nga ortaku Dorian Kodra.*
- 5.3 Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë nënshkruar dhe shlyer plotësisht nga Ortaket themelues.
- 5.4 Asnjë nga ortaket nuk mund te transferoje kuoten përkatëse te pjesëmarrjes ne Shoqëri pa miratimin paraprak me shkrim te ortakeve te tjerë. Ne rast se një nga ortaket dëshiron te kaloje/transferoje plotësisht apo pjesërisht kuotën e tij ne Shoqëri, duhet t'ia ofroje ketë kuote për blerje ortakeve te Shoqërisë. Brenda 30 (tridhjete) diteve nga ofrimi i kuotës për blerje, ortaket do te kenë te drejtë te blejnë kuotën e ofruar ne shitje sipas çmimit dhe mënyrave te pagesës për te cilat kane rene dakord me ortakun shitës.
- 5.5 Ne rast zmadhimi apo zvogëlimi te kapitalit themeltar te Shoqërisë, ortaket do te kenë te drejtë e nënshkrimit te zmadhimit apo zvogëlimit te kapitalit ne përpjesëtim te drejte me pjesëmarrjen qe zoteron secili ne kapitalin e Shoqërisë.

NENI 6

KALIMI I KUOTES ME TRASHEGIMI (MORTIS CAUSA) OSE PER SHKAK TE FALIMENTIMIT TE ORTAKUT

- 6.1 Ne rast vdekje apo falimentimi te njërit prej ortakeve, kalimi i kuotës dhe i te drejtave përkatëse ne favor te trashëgimtareve apo personave qe fitojnë këto te drejta duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme, e cila duhet te shprehet brenda 30 (tridhjete) ditëve nga njoftimi i vdekjes apo i falimentimit te ortakut. Ne rast refuzimi te pëlqimit apo nëse Asambleja e Përgjithshme nuk është shprehur brenda afatit te sipërpërmendur, Shoqëria do t'ju paguaje trashëgimtareve apo personave qe fitojnë këto te drejta vlerën e kuotës qe do te përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme, duke pasur parasysh gjendjen pasurore te Shoqërisë dhe vlerën e tregut te kuotës.
- 6.2 Personi qe fiton te drejtën mbi kuotën e pjesëmarrjes për shkak te vdekjes apo falimentimit te një ortaku mund te zgjedhe te behet zotërues i kuotës ose te kërkoje regjistrimin e kuotës ne emër te një personi tjeter te zgjedhur prej tij si përfitues i kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh te behet zotërues i kuotës, ai njofton Shoqërinë ne lidhje me këtë vendim.
- 6.3 Personi qe fiton te drejtat mbi një kuote për shkak te vdekjes apo falimentimit te një ortaku do te këtë te drejtat qe gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përashtuar te drejtën e pjesëmarrjes ose te votës ne çdo mbledhje te Asamblesë se Përgjithshme, deri ne momentin e regjistrimit ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit si zotërues i kuotës.

NENI 7

ZMADHIMI I KAPITALIT

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme mund te zmadhoje kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar ne nenin 9.10 te këtij Akt Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë se Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do ti komunikohet me shkrim ortakeve qe janë thirrur por nuk ishin te pranishëm ne mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme qe vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 7.2 Ne rast zmadhimi te kapitalit, te gjithë ortaket do te kenë te drejtën te nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, ne para ose me kontribute ne natyre, ne përpjesëtim te drejte me kuotat qe zotërojnë ne Shoqëri.
- 7.3 Ne rast se disa ortake heqin dore nga e drejta e nënshkrimit te pjesës se tyre, kapitali i panënskruar prej tyre mund te nënshkruhet nga ortaket e tjerë. Ne këtë rast, këta ortake mund te ushtrojnë serish te drejtën për nënshkrimin e kapitalit, ne përpjesëtim te drejte me kuotat e pjesëmarrjes ne Shoqëri.

NENI 8
ZVOGELIMI I KAPITALIT

- 8.1 Asambleja e Përgjithshme mund te zvogëloje kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar ne nenin 9.10 te këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Ne çdo rast kapitali i Shoqërisë nuk mund te zvogëlohet nen kufirin e përcaktuar me ligj.
- 8.2 Ortaket e përballojnë zvogëlimin e kapitalit te Shoqërisë, ne përpjesëtim te drejte me pjesëmarrjen e tyre ne kapitalin e Shoqërisë.

NENI 9
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

- 9.1 Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vend ose mbi te gjitha çështjet për te cilat është kompetente sipas ligjeve ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakeve te Shoqërisë.
- 9.2 Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e Asamblesë se Përgjithshme, te shprehe vullnetin e tij si dhe te votoje ne përputhje me pjesët e kapitalit qe ai zotëron ne Shoqëri.
- 9.3 Çdo ortak mund te përfaqësohet nga një ortak tjetër ose nga një person tjetër, me prokure me shkrim .
- 9.4 Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme mund te mbahet brenda ose jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë. Ortaket ose përfaqësuesit e autorizuar mund te marrin pjese ne mbledhjen e Asamblesë se Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshire telekonferencën (conference call) audio ose video, ne përputhje me ligjin për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare dhe ligjin për komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme do te quhet e mbajtur ne vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qellim qe te hartohet dhe te nënshkruhet procesverbali përkatës.
- 9.5 Asambleja e Përgjithshme mund te thirret nga Administratoret ose nga ortaket ne baze te nenit 84 te ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare". Thirja e mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme duhet te behet nëpërmjet njoftimit me shkrim ose mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakeve ne adresat e njoftuara Shoqërisë te paktën 7 (shtate) dite përpara datës se caktuar për mbledhjen e saj. Njoftimi duhet të përbaje rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes. Asambleja e Përgjithshme do te mblidhet

rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, kur ortaket apo përfaqësuesit e tyre janë te pranishëm dhe bien dakord te vodosin ne lidhje me rendin e ditës.

- 9.6 Mbledhjet e Asamblesë se Përgjithshme kryesohen nga Administratoret. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje ndër personat e pranishëm.
- 9.7 Vendimet e Asamblesë se Përgjithshme duhet te jene me shkrim dhe te firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë te ortakeve, vendimet duhet te perfshijne dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
- 9.8 Asambleja e Përgjithshme mblidhet te pakten një here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit finanziar.
- 9.9 Asambleja e Përgjithshme, perveçse per sa parashikon neni 9.10 i ketij Akti Themelimi dhe Statuti, per vendime qe kerkojne shumicen e zakonshme, merr vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote ose përfaqësuesit e tyre, qe zoterojne me shume se 30% (tridhjete per qind) te kapitalit te Shoqerise, sipas nenit 86 pika I, te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Mbi ndermarrjet dhe shoqerite tregetare".
- 9.10 Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro te te pakten 51 % te ortakeve pjesemarres (shumica e kualifikuar) ne baze te nenit 87 pika I, te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 "Mbi ndermarrjet dhe shoqerite tregetare", per ndryshimin e ketij Akti Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te Shoqerise, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise.

NENI10 ADMINISTRIMI I SHOQERISE

- 10.1 Shoqëria administrohet nga Administratori i cili për një periudhe prej maksimumi 5 (pese) vjetësh. Administratori mund te rizgjidhen dhe shkarkohen ne çdo kohe nga Asambleja e përgjithshme. Aktualisht Asambleja e Përgjithshme administrohet nga 1 administrator:
 - Dorian Kodra, atësia Bashkim, amësia Sadije, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Rrugë Panjohur; Durrës; 0000; Durrës, lindur më 27/02/1989, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037603456 dhe nr. personal I90227080H



- 10.2 Administratori zoteron kompetenca te plota ne lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund te kryeje te gjitha aktet qe konsideron te nevojshme për realizimin e objektit te Shoqërisë, përveç veprimeve, përbushja e te cilëve i rezervohet Asamblejë se Përgjithshme apo organeve te tjera te Shoqërisë. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera gjate administritimit te Shoqërisë dhe mund te autorizoje persona te trete, për te përbushur veprime te caktuara, ne emër dhe për llogari te Shoqërisë. Ne çdo rast, administratori do te jete përgjegjës për veprimet e te tretëve te autorizuar.
- 10.3 Asambleja e Përgjithshme vendos shpërblimin e administratoreve te shoqërisë.
- 10.4 Administratoret nuk do te mund te marrin hua nga Shoqëria ose te lëshojnë garanci, dorëzani, ne emër dhe për llogari te Shoqërisë, për hua dhe financime te dhëna nga te tretet.
- 10.5 Administratoret do te veprojnë ne çdo kohe vetëm ne interesin me te mire te Shoqërisë. Ne rast konflikti interesit, Administratori do te njoftoje menjëherë ortaket si dhe do te heqë dore nga çdo veprim qe lidhet me objektin e konfliktit te interesit deri ne marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.

**NENI 11
VITI FINANCIAR**

11.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

**NENI 12
KONTROLI FINANCIAR**

- 12.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet nga Eksperte Kontabël te Autorizuar, sipas legjisacionit shqiptar ne fuqi. Asambleja e Përgjithshme do te emëroje një apo me shume Eksperte Kontabël te Autorizuar ne atë raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërcohët ne baze te ligjit.

**NENI 13
BILANCI VJETOR**

- 13.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, raportet e organit administrativ mbi ecurinë e veprimtarisë sociale dhe te Ekspertit Kontabël te Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e përgjithshme .

- 13.2 Dokumentet qe kane te bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vtitit financiar.

**NENI 14
DIVIDENDET**

- 14.1 Ne përputhje më dispozitat ligjore, Asambleja e Përgjithshme vendos mbi shpërndarjen e dividendëve ne baze te rezultatit financiar te shoqërisë.

**NENI 15
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHEVE**

- 15.1 Mosmarrëveshjet qe mund te lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakeve, administratoreve, likuiduesit, do t'i nënshtronen juridiksonit te Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Tirane.

**NENI 16
GJUHA**

- 16.1 Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet ne 4 (katër) ekzemplare ne gjuhen shqipe.

**NENI 17
DISPOZITA PERFUNDIMTARE**

- 17.1 Shoqëria do te kryeje veprimtarinë e saj ne përputhje me ketë Akt Themelimi dhe Statut dhe ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Për sa nuk parashikohet ne ketë Akt Themelimi dhe Statut, do te zbatohen parashikimet e ligjit nr. 9901 i datës 14.04.2008 "Mbi ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare".

ORTAK I SHOQERISE
Shoqeria "SOLID 23" SHPK
Dorian Kodra


Dorian Kodra
D.Kodra

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER GJERGJ R. KONGOLI**



DATE 22.05.2023

NR REP 2927



VËRTETIM NËNSHKRIMI


Sot, më datë 22.05.2023, para meje Noter GJERGJ R. KONGOLI, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NJESIA ADMINISTRATIVE NR. 10, RR. MIHAL DURI, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES:

Dorian Kodra, atësia Bashkim, amësia Sadije, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në Durrës, me adresë Rrugë Panjohur; Durrës; 0000; Durrës, lindur më 27/02/1989, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037603456 dhe nr. personal I90227080H, i cili në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqit dhe nënshkroi përparrë meje Noterit, "Statutin dhe Aktin e Themelimit te Shoqerise "Solid 23" Shpk, bashkëlidhur.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërmë "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënavë Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



NOTER
GJERGJ R. KONGOLI